

MARRËVESHJA E SINGAPORIT PËR TË DREJTËN E MARKËS TREGTARE

Publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 19/10

Neni 1

Shkurtesa shprehjesh

Në këtë marrëveshje, përveç nëse është theksuar ndryshe:

- (i) „Enti“ do të thotë trupi i palës kontraktuese që është përgjegjëse për regjistrimin e markave tregtare;
- (ii) „Regjistrimi“ do të thotë regjistrimi i markave tregtare nga ana e Entit;
- (iii) „Aplikimi“ do të thotë aplikimi për regjistrim;
- (iv) „Paraqitje“ do të thotë çfarëdo lloj paraqitjeje apo kërkesë, deklaratë, shkresë apo informacioni tjetër në lidhje me aplikimin apo regjistrimin, që dorëzohet në Ent;
- (v) „Referimi në person“ interpretohet si referim në person fizik dhe juridik;
- (vi) „Bartësi“ do të thotë personi që në regjistrin e markave tregtare është i regjistruar si bartës i regjistrimit;
- (vii) „regjistri i markave tregtare“ do të thotë tërësia e të dhënave që i udhëheq Enti, që përfshin përmbajtjes e të gjitha regjistrimeve dhe të gjitha të dhënat e shënuara në lidhje me regjistrimet, pa marrë parasysh formën në të cilën këto të dhëna ruhen;
- (viii) „Procedurë para Entit “ do të thotë cilado procedurë para Entit në lidhje me aplikimin apo regjistrimin;
- (ix) „Konventa e Parisit “ do të thotë Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale, e nënshkruar në Paris më 20 mars të vitit 1883, e rishikuar dhe ndryshuar;
- (x) „Klasifikimi i Nicës“ do të thotë klasifikimi i vendosur me marrëveshjen e Nicës për klasifikim ndërkombëtar të produkteve dhe shërbimeve për regjistrim të markave tregtare, të nënshkruar në Nicë, më 15 qershor të vitit 1957, e rishikuar dhe ndryshuar;
- (xi) „Licencë“ do të thotë licenca për përdorimin e markës tregtare në pajtueshmëri me Ligjin e palës së kontraktuar;
- (xii) „i licencuar “ do të thotë personi të cilit iu është ndarë licenca;

(xiii) „Palë nënshkruese“ do të thotë cilido shtet apo organizatë ndërqeveritare që është palë e kësaj marrëveshjeje;

(xiv) „Konferenca diplomatike“ do të thotë takimi i palëve të kontraktuara me qëllim rishikimi apo ndryshimi të Marrëveshjes;

(xv) „Kuvendi“ do të thotë Kuvendi sipas nenit 23;

(xvi) referimet në “instrument për ratifikim” interpretohen si referime të instrumenteve për pranim dhe miratim;

(xvii) „Organizata“ do të thotë Organizata Botërore për pronësi industriale;

(xviii) „Byroja ndërkombëtare “ do të thotë Byro ndërkombëtare e Organizatës;

(xix) „Drejtori gjeneral“ do të thotë drejtori gjeneral i Organizatës;

(xx) „Rregullore“ do të thotë Rregullorja sipas nenit 22 të kësaj marrëveshjeje;

(xxi) referimi i “nenit” apo “paragraf”, “nënparagrafi” dhe “pika” të nenit interpretohet si referim të rregullave adekuate të Rregullores;

(xxii) „TLT 1994“ do të thotë Marrëveshja për të drejtat e markës tregtare të nënshkruar në Gjenevë më 27 tetor të viti 1994.

Neni 2

Markat tregtare mbi të cilat zbatohet Marrëveshja

(1) [*Natyra e markave tregtare*] Çdo palë nënshkruese do të zbatojë këtë marrëveshje të markave tregtare që përbëhen nga shenjat, që mund të regjistrohen si marka tregtare sipas ligjeve të saj.

(2) [*Llojet e markave tregtare*]

(a) Kjo Marrëveshje zbatohet mbi markat tregtare që kanë të bëjnë me produktet (markat e mallrave) apo shërbimet (markat e shërbimeve) ose njëkohësisht mbi produktet e shërbimet.

(b) Kjo marrëveshje nuk zbatohet për marka kolektive, marka certifikuese apo ato garantuese.

Neni 3

Aplikimi

(1) [*Të dhënat apo elementët që përmbahen në aplikacion ose që i bashkëngjiten asaj; taksa*]

(a) Çdo palë nënshkruese mund të kërkojë që aplikacioni të përmbajë disa ose të gjitha të dhënat apo elementët vijues:

(i) Kërkesë për regjistrim;

(ii) Emri dhe mbiemri i aplikuesit;

(iii) Emri i shtetit, shtetas i së cilit është aplikuesi, nëse është shtetas në ndonjë shtet, emri i shtetit në të cilin aplikuesi ka vendqëndrim, nëse ekziston i tillë, dhe emri i shtetit në të cilin aplikuesi ka seli reale dhe efektive industriale apo tregtare, nëse ekziston e tillë;

(iv) Kur aplikuesi është person juridik, statusin juridik të atij personi juridik dhe shteti, dhe kur është e mundur, njësinë territoriale të atij shteti sipas ligjit të të cilit është organizuar personi juridik;

(v) Kur aplikuesi ka përfaqësues, emri dhe adresa e përfaqësuesit;

(vi) Kur kërkohet adresa për shërbimin sipas nenit 4 paragrafi (2)(b), atë adresë;

(vii) Kur aplikuesi dëshiron të shfrytëzojë të drejtën e prioritetit të aplikimit paraprak, deklaratë në të cilën kërkohet e drejta e prioritetit nga ai aplikacion paraprak, bashkë me pretendimet dhe dëshmitë në shtesë të deklaratës për prioritet, që mund të kërkohen në përputhje me nenin 4 të Konventës së Parisit;

(viii) Kur aplikuesi dëshiron të shfrytëzojë ndonjë mbrojtje që del nga ekspozimi i produkteve dhe/ose shërbimeve në ekspozitë, deklaratë për atë qëllim, bashkë me dëshmi si mbështetje për atë deklaratë, siç parasheh ligji i palës nënshkruese;

(ix) Të paktën një pamje të shenjës, siç përshkruhet me rregullore;

(x) kur është e mundur, deklaratë, siç është e përshkruar me Rregullore, në të cilën do të potencohet lloji i markës tregtare, si edhe të gjitha kushtet tjera që zbatohen në at lloj marke tregtare;

(xi) kur është e mundur, deklaratë, siç është e përshkruar me Rregullore, në të cilën potencohet se aplikuesi dëshiron që marka tregtare të regjistrohet dhe publikohet me përdorimin e shenjave standarde nga ana e Entit;

(xii) kur është e mundur, deklaratë, siç është e përshkruar me Rregullore, në të cilën potencohet se aplikuesi dëshiron të kërkojë ngjyrë si element dallues i markës tregtare

(xiii) transliterim i markës tregtare apo i pjesëve të caktuara të markës tregtare;

(xiv) përkthim i markës tregtare apo pjesëve të caktuara të markës tregtare;

(xv) emrat e produkteve dhe/ose shërbimeve për të cilat kërkohet regjistrimi, të grupuara në klasa sipas klasifikimit të Nicës, me atë që para çdo grupi qëndron numri i klasës nga ai klasifikim të cilit grup produktesh apo shërbimesh i takon, të prezantuara sipas renditjes së klasave të klasifikimit të cekur;

(xvi) Deklaratë për qëllimin e shfrytëzimit të markës tregtare, siç është paraparë me ligjin e palës nënshkruese.

(b) Aplikuesi mund të dorëzojë, në vend të ose përskaj deklaratës për qëllimin e shfrytëzimit të markës tregtare nga nënparagrafi (a)(xvi), një deklaratë për shfrytëzimin e vërtetë të markës tregtare dhe dëshminë për atë, siç parashihet me ligjin e palës nënshkruese;

(c) Çdo palë nënshkruese mund të kërkojë pagesë taksash në Ent në lidhje me aplikimin.

(2) [*Një aplikimi vetëm për produktet dhe/ose shërbimet në disa klasa*] Një aplikacion i vetëm mund të ndërlidhet me disa produkte dhe/ose shërbime, pa marrë parasysh atë se i takojnë një klasë apo më shumë klasave sipas klasifikimit të Nicës.

(3) [*Shfrytëzimi i vërtetë*] Kur dorëzohet deklaratë për qëllimin e shfrytëzimit sipas paragrafit (1)(a)(xvi), çdo palë nënshkruese mund të kërkojë nga parashtruesi i aplikacionit, në afat të paraparë me ligj të palës nënshkruese, në përputhje me afatin minimal kohor të paraparë me Rregulloren, të dorëzojë deri tek Enti dëshmi për shfrytëzimin e vërtetë të markës tregtare, siç është paraparë me atë ligj.

(4) [*Ndalesa e kushteve të tjera*] Asnjë nga palët nënshkruese, në lidhje me aplikimin nuk mund të kërkojë të plotësohen kushte të tjera përveç atyre të parapara në paragrafët (1) dhe (3) dhe në nenin 8. Në veçanti, në lidhje me aplikimin në procedurë, nuk mund të kërkohen si në vijim:

(i) dorëzimi i çfarëdo vërtetimi apo certifikate nga regjistri tregtar;

(ii) tregues se aplikuesi kryen veprimtari industriale apo tregtare, si edhe të dorëzojë dëshmi për atë;

(iii) tregues se aplikuesi kryen veprimtari që korrespondon me produktet dhe/ose shërbimet të cekura në aplikacion, si edhe të dorëzojë dëshmi për to;

(iv) të dorëzojë dëshmi se marka tregtare është e regjistruar në regjistrin e markave tregtare të ndonjë pale tjetër nënshkruese apo shteti anëtarë të Konventës së Parisit që nuk është palë nënshkruese, përveç kur aplikuesi paraqet kërkesë për nenin 6quinquies të Konventës së Parisit.

(5) [Dëshmia] Çdo palë nënshkruese gjatë shqyrtimit të aplikacionit mund të kërkojë të dorëzohen dëshmi deri tek Enti, kur Enti ka dyshime të bazuara për vërtetësinë e ndonjë treguesi apo elementi të përmbajtur në aplikacion.

Neni 4 **Përfaqësimi; Adresa për shërbim**

(1) [Përfaqësues të autorizuar për përfaqësim]

(a) çdo palë nënshkruese, mund të kërkojë që përfaqësuesi që është caktuar për çfarëdo procedure pra entit,

(i) të ketë të drejtë, në përputhje me ligjin e aplikueshëm, të ndërmerr veprime para entit në lidhje me aplikacionet dhe regjistrimet, kur është e zbatueshme, t'i lejohe të përfaqësojë para Entit;

(ii) të theksohet, si adresë të tij, adresa e territorit të përshkruar nga pala nënshkruese.

(b) Veprimi, në lidhje me çfarëdo procedure para Entit, i ndërmarrë nga dhe në lidhje me përfaqësuesin, që plotëson kushtet e parapara nga pala nënshkruese sipas nënparagrafit (a), nuk do të ketë ndikim në cilindo veprim të ndërmarrë nga ose në lidhje me aplikuesin, bartësin apo ndonjë person tjetër të interesuar të cilin e ka emëruar ai përfaqësues.

(2) [Përfaqësim i detyrueshëm; Adresa për shërbimin]

(a) Pala nënshkruese mund të kërkojë, për qëllimet e cilësdo procedurë para Entit, kur aplikuesi, bartësi apo personi tjetër i interesuar nuk ka as vendbanim, e as seli të vërtetë dhe efektive industriale apo tregtare në territorin e saj, të përfaqësohet nga përfaqësues.

(b) Çdo palë nënshkruese mund, përveç nëse nuk ka të bëjë me përfaqësim sipas nënparagrafit (a), të kërkojë, për qëllimet e cilësdo procedurë para Entit, kur aplikuesi, bartësi apo cilido person tjetër i interesuar nuk ka as vendqëndrim, e as seli faktike dhe efektive industriale apo tregtare, të ketë adresë për shërbim në atë territor.

(3) [Autorizim]

(a) Kur pala nënshkruese lejon ose kërkon aplikuesi, bartësi apo cilido person tjetër i interesuar të përfaqësohet para Entit, ajo mund të kërkojë që të caktohet përfaqësues me shkresë të veçantë (në tekstin e mëposhtëm: “autorizim”) në të cilën do të ceket emri i aplikuesit, bartësit apo personit tjetër, në varësi të rastit.

(b) Autorizimi mund të ndërlidhet me një ose më shumë aplikacione dhe/ose regjistrime të caktuara në autorizim ose, përveç përjashtimeve të cekura nga autorizuesi, të të gjitha aplikimeve dhe/ose regjistrimeve ekzistuese dhe të ardhshme të atij personi.

(c) Autorizimi mund t'i kufizojë autorizimet e përfaqësuesit në veprime të caktuara. Pala nënshkruese mund të kërkojë që autorizimi, sipas së cilës përfaqësuesi (i autorizuari) ka të drejtë tërheqjen e aplikacionit ose heqje dorë nga regjistrimi, të përmbajë tregues të qartë për këtë.

(d) Kur paraqitja dorëzohet deri tek Enti nga personi që vetes në paraqitje i referohet si përfaqësues, por enti në kohën e pranimit të paraqitjes nuk e ka autorizimin e duhur, pala nënshkruese mund të kërkojë autorizimi të dorëzohet deri tek enti në afat të caktuar nga pala nënshkruese, në pajtim me afatin minimal kohor të paraparë me Rregullore. Çdo palë nënshkruese mund të parasheh , kur autorizimi nuk është dorëzuar deri tek Enti në afat të përcaktuar nga pala nënshkruese, ashtu që aplikimi i atij personi të mos ketë vlefshmëri.

(4) [*Thirrje në autorizim*] Pala nënshkruese mund t kërkojë çdo paraqitje para Entit nga ana e përfaqësuesit për qëllime të procedurave para entit, të përmbajë thirrje në autorizim në bazë të së cilës vepron përfaqësuesi.

(5) [*Ndalesa të kushteve të tjera*] Pala nënshkruese nuk mund të kërkojë të plotësohen kushte të tjera nga ato të përfshira në paragrafët (3) dhe (4) dhe nenin 8, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë këto paragrafë.

(6) [*Dëshmia*] Pala nënshkruese mund të kërkojë të dorëzohet dëshmi deri tek Enti, kur Enti ka dyshime të bazuara në vërtetësinë e ndonjë të dhënë të përmbajtur në aplikacion që referohen në paragrafët (3) dhe (4).

Neni 5 Data e dorëzimit

(1) [*Kushte të lejuara*]

(a) Në përputhje me nënpagrafin (b) dhe paragrafin (2), pala nënshkruese do ta evidentojë si datë të dorëzimit të aplikacionit datën në të cilën i ka marrë, në

gjuhën që kërkohet sipas nenit 8 paragrafi (2), treguesit dhe elementët si në vijim:

- (i) tregues i qartë ose i kuptueshëm se kërkohet regjistrimi i markës tregtare;
- (ii) tregues që mundësojnë njohjen e identitetit të aplikuesit;
- (iii) tregues që mundësojnë aplikuesi apo përfaqësuesi i tij, nëse ka të tillë, të mund të kontaktohet nga ana e Entit;
- (iv) përfaqësim mjaftueshëm të qartë të shenjës për të cilën kërkohet regjistrim;
- (v) listë e produkteve dhe/ose shërbimeve për të cilat kërkohet regjistrimi;
- (vi) kur aplikohet neni 3 paragrafi (1)(a)(xvi) ose (b), deklarata nga neni 3 paragrafi (1)(a)(xvi) ose deklaratë dhe dëshmi nga neni 3 paragrafi (1)(b), siç parashihet me ligjin e palës nënshkruese.

(b) Pala nënshkruese mund të vërtetojë si datë të dorëzimit të aplikacionit datën në të cilën enti ka marrë vetëm një pjesë, por jo edhe të gjithë treguesit dhe elementët nga nënparagrafi (a), ose i ka marrë në gjuhë që nuk është gjuhë e paraparë me nenin 8 paragrafi (2).

(2) [*Kushte të lejuara shtesë*]

(a) Pala nënshkruese mund të parasheh se nuk do të akordojë (vërtetojë) datën e dorëzimit derisa nuk paguhen taksat e parapara.

(b) Pala nënshkruese mund të zbatojë kushtin nga nënparagrafi (a) vetëm nëse atë e ka zbatuar gjatë kohës kur është bërë palë e kësaj marrëveshjeje.

(3) [*Korrigjime dhe afate kohore*] Mënyrat dhe afatet për korrigjime sipas paragrafëve (1) dhe (2) janë të përcaktuara me Rregullore.

(4) [*Ndalesë për kushte të tjera*] Pala nënshkruese, në lidhje me datën e dorëzimit, nuk mund të kërkojë të plotësohen kushte të tjera të ndryshme përveç atyre të parapara në paragrafët (1) dhe (2).

Neni 6

Regjistrim i vetëm i produkteve dhe/ose shërbimeve në disa klasa

Kur produktet dhe/ose shërbimet që i takojnë disa klasave sipas klasifikimit të Nicës përmbahen në një aplikacion të njëjtë, aplikacioni i tillë rezulton me një regjistrim të vetëm dhe të njëjtë.

Neni 7

Ndarja e aplikacionit dhe regjistrimit

(1) [*Ndarja e aplikacionit*]

(a) Çdo aplikacion në të cilin listohen më shumë produkte dhe/ose shërbime (në tekstin e mëposhtëm “aplikacion paraprak”) mund:

(i) derisa Enti nuk sjell vendim për regjistrimin e markës tregtare,

(ii) gjatë periudhës së procedurës pas kundërshtimit kundër vendimit për regjistrimin e markës tregtare,

(iii) gjatë periudhës së procedurës pas ankimimit kundër vendimit për regjistrimin e markës tregtare,

Të ndahet nga ana e aplikuesit ose me kërkesë të tij në dy e më shumë aplikacione (në tekstin e mëposhtëm: “aplikacione të ndara”) me ndarjen e produkteve dhe/ose shërbimeve të përmbajtura në aplikacionin paraprak midis aplikacioneve të ndara. Aplikacionet e ndara mbajnë datën e dorëzimit të aplikacionit paraprak dhe të drejtën e prioritetit, nëse kanë një të tillë.

(b) Çdo palë nënshkruese, në pajtim me nënparagrafin (a) mund të përcaktojë kushte për ndarje të aplikacionit, përfshirë edhe pagesën e taksave.

(2) [*Ndarja e regjistrimit*] Paragrafi (1) aplikohet, *mutatis mutandis* në lidhje me ndarjen e regjistrimit. Kjo ndarje lejon:

(i) gjatë periudhës së cilësdo procedurë gjatë së cilës sfidohet vlefshmëria e regjistrimit para Entit nga person i tretë,

(ii) gjatë periudhës së cilësdo procedurë pas ankesës kundër vendimit që ka sjellë Enti gjatë procedurës paraprake,

gjatë së cilës, pala nënshkruese të mund të përjashtojë mundësinë për ndarje të regjistrimeve, nëse ligji i saj lejon palë të treta të dorëzojnë ankesë mbi regjistrimin e markës tregtare para se marka të regjistrohet.

Neni 8

Paraqitja (Komunikimi)

(1) *[Mjetet e transmetimit dhe forma e shkresave]* Çdo palë nënshkruese mund të zgjedh mjetet e transmetimit të shkresave dhe se a pranon shkresën në letër, në formë elektronike apo ndonjë formë tjetër të komunikimit.

(2) *[Gjuha e komunikimit]*

(a) Pala nënshkruese mund të kërkojë që çdo komunikim të jetë në gjuhën e lejuar nga ana e Entit. Kur Enti lejon komunikimi të kryhet ë më shumë se një gjuhë, Enti mund të kërkojë nga aplikuesi, bartësi apo ndonjë person tjetër i interesuar, të dorëzohet edhe në gjuhë tjetër që njih Enti, me kusht që të mos kërkohet që treguesit apo elementët e shkresave të dorëzohen në më shumë se një gjuhë.

(b) Pala nënshkruese nuk mund të kërkojë deklaratë, noterizim, autenticitet, legalizim apo vërtetim tjetër të cilitdo përkthim të shkresave, përveç siç është paraparë me këtë marrëveshje.

(c) Kur pala nënshkruese nuk kërkon komunikimi të jetë në gjuhën e lejuar nga Enti i saj, Enti mund të kërkojë që përkthimi i atyre shkresave i bërë nga ana e përkthyesit ose përfaqësuesit zyrtar në gjuhën e lejuar nga Enti, të dorëzohet në afat të arsyeshëm kohor.

(3) *[nënshkrimi i shkresave në letër]*

(a) Pala nënshkruese mund të kërkojë shkresat në letër të nënshkruhen nga aplikuesi, bartësi apo person tjetër i interesuar. Kur pala nënshkruese kërkon që shkresat në letër të nënshkruhen atëherë pala nënshkruese pranon çdo nënshkrim që plotëson kushtet e parapara me Rregullore.

(b) Asnjë nga palët nënshkruese nuk mund të kërkojë deklaratë, noterizim, autenticitet, legalizim apo vërtetim tjetër, përveç nëse nënshkrimi ka të bëjë me çregjistrimin dhe kur ligji i palës nënshkruese e parasheh atë.

(c) Pa marrë parasysh nënparagrafin (b), pala nënshkruese mund të kërkojë që të dorëzohet dëshmi deri tek Enti, kur Enti ka dyshime të bazuara në autenticitetin e cilitdo nënshkrim të shkresave në letër.

(4) *[Shkresat në formë elektronike ose me mjete elektronike të komunikimit]* Kur pala nënshkruese lejon dorëzimin e shkresave në formë elektronike ose me mjete elektronike të komunikimit, mund të kërkojë çdo shkresë të jetë në përputhje me kushtet e përshkuara me Rregullore.

(5) *[Dorëzimi i shkresave]* Çdo palë nënshkruese pranon dorëzimin e shkresave përmbajtja e të cilave përgjigjet me modelin përkatës të formularit ndërkombëtar, nëse është paraparë ashtu me Rregullore.

(6) *[Ndalesa e kushteve tjera]* Asnjë nga palët nënshkruese nuk mund të kërkojë të përmbushen kushtet në lidhje me paragrafët nga (1) deri në (5), përveç atyre nga ky nen.

(7) *[Mjetet e komunikimit me përfaqësues]* Ky nen nuk i rregullon mjetet për komunikim midis aplikuesit, bartësit ose personit tjetër të interesuar dhe përfaqësuesit të tij.

Neni 9

Klasifikimi i produkteve dhe/ose shërbimeve

(1) *[Treguesit e produkteve dhe/ose shërbimeve]* Në çdo regjistrim dhe në çdo publikim të kryer nga Enti, që kanë të bëjnë me aplikimin ose regjistrimin dhe në të cilin citohen produktet dhe/ose shërbimet – produktet dhe/ose shërbimet citohen sipas emrit të tyre, të grupuara sipas klasave të klasifikimit të Nicës, ndërkohë që para secilit grup qëndron numri i klasës së klasifikimit të Nicës se cilit grup të produkteve ose shërbimeve i takon dhe atë sipas renditjes së klasave në klasifikimin e cekur.

(2) *[Produkte dhe shërbime në klasë të njëjtë ose në klasa të ndryshme]*

(a) Produktet dhe shërbimet në cilindo regjistrim apo publikim nga Enti nuk mund të konsiderohen të ngjashëm midis vete në bazë të asaj se bien në të njëjtën klasë të klasifikimit të Nicës.

(b) Produktet dhe shërbimet në cilindo regjistrim apo publikim nga Enti nuk mund të konsiderohen të ndryshëm midis vete në bazë të asaj se bien në klasa në ndryshme të klasifikimit të Nicës.

Neni 10

Ndryshime në emra dhe adresa

(1) *[Ndryshime në emrin ose adresën e bartësit]*

(a) Kur nuk ka ndryshim të bartësit, por ka ndryshim në emrin e tij dhe/ose adresën e tij, pala nënshkruese do të pranojë kërkesën për regjistrimin e ndryshimit në regjistrin e markave tregtare të Entit nga ana e bartësit, me shkresë ku do të potencohet numri i regjistrimit dhe ndryshimi që duhet të futet.

(b) Pala nënshkruese mund të kërkojë që në kërkesë të ceken

(i) emri dhe adresa e bartësit;

(ii) kur bartësi ka përfaqësues, emri dhe adresa e përfaqësuesit;

(iii) kur bartësi ka adresë për shërbime, atë adresë.

(c) Pala nënshkruese mund të kërkojë, në lidhje me kërkesën, të paguhen edhe taksa në Ent.

(d) Një kërkesë e vetme do të jetë e mjaftueshme edhe kur ndryshimi ka të bëjë me më shumë se një regjistrim, me kusht që numrat e regjistrimit të të gjithë regjistrimeve për të cilat bëhet fjalë të ceken në kërkesë.

(2) [Ndryshime në emrin ose adresën e aplikuesit] Paragrafi (1) aplikohet *mutatis mutandis* kur ndryshimi ka të bëjë me aplikimin ose aplikimet dhe regjistrimin ose regjistrimet, me kusht, kur numri i aplikimit të cilitdo aplikim ende të mos jetë dhënë ose nuk i është bërë i njohur aplikuesit ose përfaqësuesit të tij, kërkesa në mënyrë tjetër të identifikojë aplikacionin siç është paraparë me Rregullore.

(3) [Ndryshim në emrin ose adresën e përfaqësuesit ose adresën për shërbime] Paragrafi (1) zbatohet, *mutatis mutandis* në çfarëdo ndryshimi në emrin ose adresën e përfaqësuesit, nëse ka të tillë, dhe në çdo ndryshim të lidhur me adresën për shërbime, nëse ka të tillë.

(4) [Ndalesë për kushte të tjera] Pala nënshkruese nuk mund të kërkojë që kushtet, përveç atyre nga paragrafët (1) deri (3) dhe nga neni 8, të plotësohen lidhur me kërkesën nga ky nen. Në veçanti, nuk mund të kërkohet dorëzimi i çfarëdo qoftë certifikate në lidhje me ndryshimin.

(5) [Dëshmi] Pala nënshkruese mund të kërkojë të dorëzohet dëshmi deri tek Enti kur Enti ka dyshime të bazuara në vërtetësinë e cilitdo tregues të kërkesës.

Neni 11 **Ndryshimi i bartësit**

(1) [Ndryshimi i bartësit të regjistrimit]

(a) Kur ka ndryshim të bartësit, pala nënshkruese do të pranojë kërkesën për regjistrimin e ndryshimit në regjistrin e markave tregtare të cilin e udhëheq Enti, nga ana e bartësit ose personit që është bërë bartës i ri (në tekstin e mëposhtëm “bartës i ri”), me një shkresë ku potencohet numri i regjistrimit dhe ndryshimi që duhet të futet (regjistrohet).

(b) Kur ndryshimi i bartësit rezulton nga një marrëveshje, pala nënshkruese mund të kërkojë që në kërkesë të ceket ky fakt, dhe sipas zgjedhjes së palës që kërkon, të dorëzohet një nga vijueset:

(i) kopje e marrëveshjes, për të cilën mund të kërkohet të jetë e noterizuar nga noter apo trup tjetër përgjegjës se përgjigjet me marrëveshjen origjinale;

(ii) ekstrakt nga marrëveshja që tregon ndryshimin e bartësit, për të cilin mund të kërkohet të jetë i noterizuar nga noteri apo trup tjetër përgjegjës se është ekstrakt i vërtetë nga marrëveshja.

(iii) certifikatë të pavërtetuar për transferim, e përpiluar në formë dhe përmbajtje siç është përshkruar me Rregullore dhe i nënshkruar nga bartësi dhe bartësi i ri;

(iv) dokument të pavërtetuar për transfer, të përpiluar në formë dhe përmbajtje siç është përshkruar me Rregullore dhe i nënshkruar nga bartësi dhe bartësi i ri;

(c) Kur ndryshimi i bartësit rezulton nga bashkimi (shkrirja), pala nënshkruese mund të kërkojë në kërkesë të ceket ky fakt dhe të bashkëngjitet kopja e dokumentit që lëshohet nga trupi adekuat dhe dëshmia për bashkimin (shkrirjen), siç është kopja e regjistrimit tregtar dhe nga ana e trupit që ka lëshuar dokumentin ose nga ana e noterit apo trupi tjetër përgjegjës të vërtetohet se kopja përgjigjet me dokumentin origjinal.

(d) Kur ka ndryshime në personin e një ose më shumë, por jo të gjithë bashkë-bartësit, dhe ndryshimi i tillë i bartësit rezulton me marrëveshje apo bashkim (shkrirje), pala nënshkruese mund të kërkojë që çdo bashkë-bartës për të cilin ka ndryshim të jap pëlqim të qartë për ndryshimin në dokument të nënshkruar nga ai.

(e) Kur ndryshimi i bartësit nuk rezulton nga marrëveshja apo bashkimi, por nga një bazë tjetër, për shembull, nga zbatimi i ligjit apo vendimi gjyqësor, pala nënshkruese mund të kërkojë në kërkesë të ceket ky fakt dhe të shoqërohet me kopjen e dokumentit, që evidenton ndryshimin, dhe ajo kopje të jetë e vërtetuar se përgjigjet me dokumentin origjinal nga ana e trupit që ka lëshuar atë dokument ose nga noteri apo trup tjetër përgjegjës.

(f) Çdo palë nënshkruese mund të kërkojë në kërkesë të ceket

(i) emri dhe adresa e bartësit;

(ii) emri dhe adresa e bartësit të ri;

(iii) emri i shtetit shtetas i të cilit është bartësi i ri, nëse është shtetas i cilitdo shtet, emri i shtetit në të cilin bartësi ka vendbanim, nëse ka të tillë dhe emri i

shtetit në të cilin bartësi i ri ka seli faktike dhe efektive industriale apo tregtare, nëse ka të tillë;

(iv) kur bartësi i ri është person juridik, natyra juridike e atij personi dhe shteti dhe, kur është e mundur, njësia territoriale e atij shteti, sipas të cilit ligj është organizuar ai person juridik;

(v) kur bartësi ka përfaqësues, emri dhe adresa e përfaqësuesit;

(vi) kur bartësi ka adresë për shërbime, atë adresë;

(vii) kur bartësi i ri ka përfaqësues, emri dhe adresa e përfaqësuesit;

(viii) kur nga bartësi i ri kërkohet të ketë adresë për shërbime sipas nenit 4 paragrafi (2) (b), atë adresë.

(g) Pala nënshkruese mund të kërkojë, për kërkesën t'i paguhen taksa Entit.

(h) Një kërkesë e vetme do të jetë e mjaftueshme edhe kur ndryshimi ka të bëjë me më shumë se një regjistrim, me kusht bartësi dhe bartësi i ri të jenë të njëjtë për çdo regjistrim dhe numrat e regjistrimit të cekur në kërkesë.

(i) Kur ndryshimi i bartësit nuk ka të bëjë me të gjitha produktet dhe/ose shërbimet e cekura në regjistrimin e bartësit dhe ligji që aplikohet lejon regjistrimin e ndryshimit të tillë, Enti kryen regjistrim të veçantë lidhur me produktet dhe/ose shërbimet për të cilat është kryer ndryshimi.

(2) [Ndryshim në bartësin e aplikacionit] Paragrafi (1) aplikohet *mutatis mutandis* kur ndryshimi ka të bëjë me një ose më shumë aplikacione dhe një ose më shumë regjistrime, me kusht, kur numri i cilitdo aplikacion ende të mos jetë lëshuar ose të mos jetë i njohur aplikuesit ose përfaqësuesit të tij, në kërkesë në mënyrë tjetër të identifikohet aplikacioni siç është paraparë me Rregullore.

(3) [Ndalesë për kushte të tjera] Pala nënshkruese nuk mund të kërkojë të plotësohen kushte të tjera në lidhje me kërkesën, përveç atyre nga paragrafi (1) dhe (2) i këtij neni dhe nga neni 8. Në veçanti nuk mund të kërkojë si në vijim:

(i) në pajtim me paragrafin (1)(c), dorëzim të çfarëdo vërtetimi apo ekstrakti nga regjistri tregtar;

(ii) dokument për kryerje të veprimtarisë industriale apo tregtare të bartësit të ri, si edhe dorëzimin e dëshmisë për të;

(iii) dokument për kryerje veprimtarie nga ana e bartësit të ri që korrespondon me produktet dhe/ose shërbimet e përfshira me ndryshimin e bartësit si dhe dorëzimin e dëshmisë për to;

(iv) dokument se bartësi ia dorëzon plotësisht ose pjesërisht biznesin e tij ose renomenë adekuate përkatëse bartësit të ri si dhe sigurimin e dëshmisë për të.

(4) [Dëshmia] Pala nënshkruese mund të kërkojë të dorëzohet dëshmi apo dëshmi shtesë deri tek Enti kur aplikohet paragrafi (1)(c) apo (d), nëse Enti ka dyshime të bazuara në vërtetësinë e cilitdo dokument që përmbahet në kërkesë apo në cilindo dokument në lidhje me këtë nen.

Neni 12 **Korrigjimi i gabimit**

(1) [Korrigjimi i gabimit në lidhje me regjistrimin]

(a) Pala nënshkruese do të pranojë kërkesë për korrigjimin e gabimit që është bërë në aplikacion apo në ndonjë kërkesë tjetër të dorëzuar deri tek Enti dhe që është përmbajtur në regjistrin e tij të markave tregtare dhe/ose në çfarëdo publikimi nga ana e Entit – kërkesa është e përmbajtur në aplikimin e bartësit ku është cekur numri i regjistrimit, gabimi që duhet të korrigjohet dhe përmirësimi që duhet të regjistrohet (futet).

(b) Pala nënshkruese mund të kërkojë që në kërkesë të ceken:

(i) emri dhe adresa e bartësit;

(ii) kur bartësi ka përfaqësues, emri dhe adresa e atij përfaqësuesi;

(iii) kur bartësi ka adresë për shërbime, atë adresë.

(c) Pala nënshkruese mund të kërkojë, në lidhje me kërkesën, t'i paguhen taksa Entit.

(d) Një kërkesë e vetme është e mjaftueshme edhe kur korrigjimi ka të bëjë me më shumë se një regjistrim të të njëjtit person, me kusht ai gabim dhe korrigjimi i kërkuar të jenë të njëjtë për çdo regjistrim dhe numrat e regjistrimit të të gjithë regjistrimeve të ceken në kërkesë.

(2) [Korrigjimi i gabimit në lidhje me aplikacionin] Paragrafi (1) aplikohet *mutatis mutandis* kur gabimi ka të bëjë me një ose më shumë aplikime ose një ose më shumë regjistrime, me kusht, kur numri i çdo aplikimi ende të mos jetë lëshuar ose të mos jetë i njohur për aplikuesin apo përfaqësuesin e tij, në kërkesë në mënyrë tjetër të identifikohet aplikacioni siç është përshkruar me Rregullore.

(3) [*Ndalesë për kushte të tjera*] Pala nënshkruese nuk mund të kërkojë të plotësohen kushte të tjera përveç atyre nga paragrafët (1) dhe (2) dhe nga neni 8, në lidhje me kërkesën nga ky nen.

(4) [*Dëshmi*] Pala nënshkruese mund të kërkojë të dorëzohet dëshmi deri tek Enti kur Enti ka dyshime të bazuara se gabimi në fjalë me të vërtetë është gabim.

(5) [*Gabime të Entit*] Enti i palës nënshkruese i korrigjon gabimet e veta sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë, pa kompensim në para.

(6) [*Gabime të pakorrigjueshme*] Pala nënshkruese nuk do të obligohet të zbatojë paragrafët (1), (2) dhe (5) për çfarëdo gabimi që nuk mund të korrigjohet sipas ligjit të saj.

Neni 13

Vlefshmëria dhe ripërtëritja e regjistrimit

(1) [*Tregues apo elementë që përmbahen ose bashkëngjiten me kërkesën për ripërtëritje; taksa*]

(a) Pala nënshkruese mund të kërkojë ripërtëritja e regjistrimit të jetë lëndë e dorëzimit të kërkesës dhe kërkesa e tillë të përmbajë disa ose të gjitha nga dokumentet e mëposhtme:

(i) dokument se kërkohet ripërtëritje;

(ii) emri dhe adresa e bartësit;

(iii) numri i regjistrimit për regjistrimin për të cilin bëhet fjalë;

(iv) sipas zgjedhjes së palës nënshkruese, datën e dorëzimit të aplikacionit që rezulton me regjistrim adekuat ose datën e regjistrimit të regjistrimit adekuat;

(v) kur bartësi ka përfaqësues, emri dhe adresa e përfaqësuesit;

(vi) kur bartësi ka adresë për shërbime, atë adresë;

(vii) kur pala nënshkruese lejon ripërtëritja e regjistrimit të kryhet vetëm për disa produkte dhe/ose shërbime të evidentuara në regjistrin e markave tregtare dhe kërkohet ripërtëritje e tillë, emrat e produkteve dhe/ose shërbimeve të evidentuara për të cilat kërkohet ripërtëritje dhe emrat e produkteve të evidentuara (regjistruara) për të cilat nuk kërkohet ripërtëritje, të grupuara sipas klasifikimit të Nicës, ku para çdo grupe paraprin numri i klasës nga ai klasifikim

se cilit grup produktesh apo shërbimesh i takon edhe atë sipas renditjes së klasave të klasifikimit të cekur;

(viii) kur pala nënshkruese lejon të dorëzohet kërkesë për ripërtëritje nga një person që nuk është bartës apo përfaqësues i tij dhe kërkesa dorëzohet nga ai, emri dhe adresa e personit.

(b) Pala nënshkruese mund të kërkojë, në lidhje me kërkesën për ripërtëritje, që Entit t'i paguhen taksa. Pasi të paguhen taksat në lidhje me periudhën fillestare të regjistrimit ose cilëndo periudhë të ripërtëritjes, nuk mund të kërkohet pagesë shtesë për mirëmbajtjen e regjistrimit në lidhje me atë periudhë. Shpenzimet lidhur me dorëzimin e deklaratës dhe/ose dëshmisë për shfrytëzim nuk do të konsiderohen, për qëllimet e këtij nënparagrafi, për pagesa të nevojshme për mirëmbajtjen e regjistrimit dhe ky nënparagraf nuk do të ketë ndikim mbi to.

(c) Pala nënshkruese mund të kërkojë që deri tek Enti të dorëzohet kërkesë për ripërtëritje dhe të paguhet taksë përkatëse sipas nënparagrafit (b), në afat të përcaktuar me ligj të palës nënshkruese, në pajtim me afatet minimale të përshkruara me Rregullore.

(2) [*Ndalesa për kushte të tjera*] Asnjë nga palët nënshkruese nuk mund të kërkojë të plotësohen kushte të tjera në lidhje me kërkesën për ripërtëritje, përveç atyre nga paragrafi (1) dhe nga neni 8. Në veçanti, nuk mund të kërkojnë si në vijim:

(i) çfarëdo qoftë riprodhimi (prezantimi) apo identifikimi tjetër të markës tregtare;

(ii) dorëzimin e dëshmisë në lidhje me atë se marka tregtare është e regjistruar ose se regjistrimi i saj është ripërtërirë në ndonjë regjistër tjetër të markave tregtare;

(iii) dorëzimin e deklaratës dhe/ose dëshmisë për përdorimin e markës tregtare.

(3) [*Dëshmia*] Pala nënshkruese mund të kërkojë që dëshmia të dorëzohet deri tek Enti gjatë shqyrtimit të kërkesës për ripërtëritje, kur Enti ka dyshime të bazuara në vërtetësinë e cilitdo dokument (tregues) apo element që përmbahet në kërkesën për ripërtëritje.

(4) [*Ndalesë për shqyrtim të hollësishëm*] Asnjë Ent i palës nënshkruese, për qëllim të ripërtëritjes, nuk mund të shqyrtojë regjistrimin në hollësi.

(5) [*Kohëzgjatja*] Kohëzgjatja e periudhës fillestare të regjistrimit dhe kohëzgjatja e secilës periudhë të ardhshme të ripërtëritjes është 10 vite.

Neni 14

Masa lehtësuese në rast të mosrespektimit të afateve

(1) [*Masa lehtësuese para skadimit të afatit*] Pala nënshkruese mund të parashoh vazhdimin e afatit për ndërmarrjen e veprimeve në procedurë para Entit në lidhje me aplikimin ose regjistrimin, nëse për këtë dorëzohet kërkesë deri tek Enti, para skadimit të afatit.

(2) [*Masa lehtësuese pas skadimit të afatit*] Kur aplikuesi, bartësi apo person tjetër i interesuar nuk arrin të respektojë afatin (“afatin përkatës”) për ndërmarrjen e veprimeve në procedurë para Entit të palës nënshkruese në lidhje me aplikimin ose regjistrimin, pala nënshkruese do të parashohë një ose më shumë nga masat lehtësuese vijuese, në pajtim me kushtet e parapara në Rregullore, nëse për këtë dorëzohet kërkesë deri tek Enti:

(i) vazhdimin e afatit përkatës për periudhë të përkohshme në rregullore;

(ii) procedim të vazhdueshëm të procedurës në lidhje me aplikimin apo regjistrimin;

(iii) rivendosjen e së drejtës së aplikuesit, bartësit apo personit tjetër të interesuar në lidhje me aplikacionin apo regjistrimin, nëse Enti vërteton se mosrespektimi i afatit ka ndodhur edhe përkaj kujdesit të shfaqur nga rrethanat e krijuara ose se mosrespektimi ka qenë i paqëllimshëm, sipas zgjedhjes së palës nënshkruese.

(3) [*Përrjashtime*] Nga asnjë palë nënshkruese nuk mund të kërkohej të parashohë masa lehtësuese nga paragrafi (1) në lidhje me përrjashtimet e përrshkruara me Rregullore.

(4) [*Taksa*] Pala nënshkruese mund të kërkojë pagesën e taksave në lidhje me masat lehtësuese sipas paragrafëve (1) dhe (2).

(5) [*Ndalesë për kushte tjera*] Pala nënshkruese nuk mund të kërkojë plotësimin e kushteve tjera, përveç atyre nga ky nen dhe neni 8, në lidhje me çfarëdo qoftë masash lehtësimi nga paragrafi (2).

Neni 15

Detyrimi për t’iu përmbajtur Konventës së Parisit

Pala nënshkruese duhet t’i përmbahet dispozitave të Konventës së Parisit që kanë të bëjnë me markat tregtare.

Neni 16

Markat e shërbimeve

Pala nënshkruese do t'i regjistrojë markat e shërbimeve dhe për markat e tilla do të aplikojë dispozitat e Konventës së Parisit që kanë të bëjnë me markat tregtare.

Neni 17

Kërkesë për evidentimin e licencës

(1) [*Kushtet në lidhje me kërkesën për evidentim*] Kur ligji i palës nënshkruese parasheh evidentimin e licencës në Entin e saj, ajo palë nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa për evidentim:

- (i) të dorëzohet në pajtim me kushtet e parapara me Rregullore, dhe
- (ii) të shoqërohet me dokumente shtesë të përshkuara me Rregullore.

(2) [*Taksa*] Çdo palë nënshkruese mund të kërkojë, në lidhje me evidentimin e licencës, të paguhet taksa deri tek Enti.

(3) [*Një kërkesë e ndërlidhur me disa regjistrime*] Një kërkesë do të jetë e mjaftueshme edhe kur licenca ka të bëjë me më shumë regjistrime, me kusht që në kërkesë të ceken numrat e regjistrimit të të gjithë regjistrimeve, bartësi dhe pranuesi i licencës të jenë të njëjtë për të gjithë regjistrimet, dhe në kërkesë të potencohet vëllimi i licencës, në pajtim me Rregulloren, në lidhje me të gjitha regjistrimet.

(4) [*Ndalesë për kushte të tjera*]

(a) Pala nënshkruese nuk mund të kërkojë të plotësohen kushte të tjera, përveç atyre nga paragrafët (1) dhe (3) dhe nga neni 8, në lidhje me evidentimin e licencës në Ent. Në veçanti nuk mund të kërkojë:

- (i) dorëzimin e certifikatës për regjistrim të markës tregtare që është lëndë e licencës;
- (ii) dorëzimin e marrëveshjes për licencë apo përkthim të të njëjtit;
- (iii) tregues për kushtet financiare të marrëveshjes për licencë.

(b) Nënparagrafi (a) është pa pasoja të dëmshme për cilin do obligim që ekziston me ligjin e palës nënshkruese, në lidhje me zbulimin e informacioneve për qëllime të tjera nga regjistrimi i licencës në regjistrin e markave tregtare.

(5) [*Dëshmia*] Pala nënshkruese mund të kërkojë të dorëzohet dëshmi deri tek Enti, kur Enti banueshëm dyshon në vërtetësinë e cilitdo informacion që përmbahet në kërkesë apo dokument tjetër të cekur në Rregullore.

(6) [*Kërkesa të lidhura me aplikacionet*] Paragrafët nga (1) deri (5) aplikohen *mutatis mutandis* në kërkesa për evidentimin (regjistrimin) e licencave për aplikacione, kur ligji i palës nënshkruese parasheh një evidentim të tillë.

Neni 18

Kërkesë për ndryshim apo anulim të regjistrimit të licencës

(1) [*Kushtet në lidhje me kërkesën*] Kur ligji i palës nënshkruese parasheh regjistrimin e licencës në Entin e saj, ajo palë nënshkruese mund të kërkojë, kërkesa për ndryshimin apo anulimin e regjistrimit të licencës:

(i) të dorëzohet në pajtueshmëri me kushtet e parapara me Rregullore, dhe

(ii) të shoqërohet me dokumente plotësuese të parapara me Rregullore.

(2) [*Kushte të tjera*] Neni 17 paragrafët (2) deri (6) do të zbatohen *mutatis mutandis* në kërkesat për ndryshimin apo anulimin e regjistrimit të licencës.

Neni 19

Pasoja nga mosregjistrimi i licencës

(1) [*Vlefshmëria e regjistrimit dhe mbrojtja e markës tregtare*] Mosregjistrimi i licencës në Ent apo institucion tjetër të autorizuar të palës nënshkruese nuk do të ketë pasoja negative për vlefshmërinë e regjistrimit të markës tregtare e cila është lëndë e licencës apo për mbrojtjen e asaj marke.

(2) [*Të drejta të caktuara të pranuesit të licencës*] Pala nënshkruese nuk mund të kërkojë regjistrimi i licencës të jetë kusht për çfarëdo të drejte që pranuesi i licencës mund t'i ketë në pajtueshmëri me ligjin e palës nënshkruese për t'u kyçur në procedurën për shkeljen e të drejtave që ka iniciuar bartësi ose të fitojë përmes asaj procedure dëmshpërblim për shkak të lëndimit të së drejtës së markës tregtare e cila është lëndë e asaj licence.

(3) [*Përdorimi i markës tregtare kur nuk është e regjistruar licenca*] Pala nënshkruese nuk mund të kërkojë regjistrimi i licencës të paraqes kusht përdorimi të markës tregtare nga ana e pranuesit të licencës të konsiderohet se përfaqëson përdorim nga ana e bartësit në procedurat për njohje, mirëmbajtje dhe zbatim të markave tregtare.

Neni 20

Përcaktimi i licencës

Kur ligji i palës nënshkruese kërkon përcaktim se marka tregtare përdoret në bazë të licencës, mosplotësimi i plotë apo i pjesshëm i atij kushti nuk do të ketë ndikim në vlefshmërinë e regjistrimit të markës tregtare e cila është lëndë e licencës apo e mbrojtjes së asaj marke tregtare dhe nuk do të ketë ndikim zbatimi i nenit 19 (3).

Neni 21

Vërejtje në raste të refuzimit të qëllimshëm

Aplikacioni në pajtim me nenin 3 ose kërkesa nga nenet 7, nga 10 deri 14, 17, 18 nuk mund të refuzohet në tërësi apo pjesërisht nga ana e Entit pa mos iu dhënë mundësi aplikuesit apo kërkuarit, në varësi të rastit, të jap vërejtje në refuzimin e qëllimshëm në afat të arsyeshëm kohor. Në lidhje me nenin 14, nga Enti nuk mund të kërkohet të jap mundësi për vërejtje kur personi që kërkon masa lehtësuese vetëm se ka pasur mundësi të dorëzojë vërejtje për faktet mbi të cilat bazohet vendimi.

Neni 22

Rregullore

(1) [Përmbajtja]

(a) Rregullorja në shtesë të kësaj marrëveshjeje përmban rregulla në lidhje me:

(i) çështje për të cilat kjo marrëveshje qartë parasheh se “janë të përshkruara (parapara) me rregullore”;

(ii) detaje që janë të dobishme në zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje; dhe

(iii) kërkesa, çështje apo procedura administrative

(b) Rregullorja, gjithashtu, përmban modele të formularëve ndërkombëtarë.

(2) [Ndryshimi i rregullores] Lëndë e paragrafit (3), çdo ndryshim i Rregullores kërkon miratim me tri të katërtat e votave.

(3) [Kusht për unanimitet]

(a) Me Rregullore mund të specifikohen dispozitat e Rregullores që mund të ndryshohen vetëm me unanimitet (njëzëshëm).

(b) Çdo ndryshim i Rregullores që rezulton me plotësim të dispozitave apo fshirje të dispozitave të përcaktuara me Rregullore, në pajtueshmëri me nënparagrafin (a), kërkonë unanimitet.

(c) Në përcaktimin se a është arritur unanimitet, vetëm votat që jepen do të merren parasysh. Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

(4) [Mospërputhje midis Marrëveshjes dhe Rregullores]

Në rast të konfliktit (mospërputhjes) midis dispozitave të kësaj marrëveshjeje dhe atyre të Rregullores, zbatohen dispozitat e Marrëveshjes.

Neni 23 Kuvendi

(1) [Përbërja]

(a) Palët nënshkruese kanë Kuvend.

(b) Çdo palë nënshkruese është e përfaqësuar në Kuvend me një delegat, të cilit mund të i ndihmojnë zëvendës delegatë, këshilltarë dhe ekspertë. Çdo delegat mund të përfaqësojë vetëm një palë nënshkruese.

(2) [Detyrat] Kuvendi

(i) merret me çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin e kësaj marrëveshjeje;

(ii) ndryshon Rregulloren, përfshirë edhe modelet e formularëve ndërkombëtarë;

(iii) përcakton kushtet për datën e aplikimit për çdo amendament nga pika (ii); dhe

(iv) kryen funksione të tjera, për zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

(3) [Kuorumi]

(a) Gjysma e anëtarëve të Kuvendit, që janë shtetet, e përbëjnë kuorumin.

(b) Pa marrë parasysh paragrafin (a), nëse në ndonjë seancë numri i anëtarëve të shteteve që janë të përfaqësuar në Kuvend është më i vogël se gjysma, por është i barabartë ose më i madh se një e treta e vendeve anëtare të Kuvendit, Kuvendi mund të sjell vendime, por, me përjashtim të vendimeve që kanë të bëjnë me vetë procedurat e tij, të gjitha këto vendime hyjnë në fuqi vetëm nëse janë plotësuar kushtet që janë të përcaktuara në tekstin e mëposhtëm. Byroja Ndërkombëtare dorëzon vendimet e cekura deri tek shtetet anëtare të Kuvendit të cilat nuk janë të pranishme dhe i fton në formë të shkruar të japin votën e tyre ose të përmbahen nga votimi në afat prej tre muajsh nga data e dorëzimit. Nëse pas kalimit të kësaj periudhe, numri i anëtarëve të cilët në këtë mënyrë kanë dhënë votën e tyre ose janë deklaruar si të përmbajtur, arrin numrin e anëtarëve që mungonte për të arritur kuorumin për vetë seancën, vendimet e këtilla hyjnë në fuqi me kusht njëkohësisht të arrihet shumica e nevojshme.

(4) *Sjellja e vendimeve në Kuvend*

(a) Kuvendi sipas rregullit sjell vendime me konsensus.

(b) Kur vendimi nuk mund të silllet me konsensus, çështja për të cilën bëhet fjalë zgjidhet me votim. Në atë rast,

(i) çdo palë nënshkruese që është shtet ka një votë dhe voton vetën në emër të vet; dhe

(ii) çdo palë nënshkruese që është organizatë ndërqeveritare mund të merr pjesë në votim në vendin e anëtarëve-shtete të tyre, që janë palë në këtë marrëveshje. Asnjë organizatë e tillë ndërqeveritare nuk mund të merr pjesë në votim nëse ndonjëri nga anëtarët-shtete përdor të drejtën e saj dhe e kundërta. Përkaj kësaj, asnjë organizatë e tillë ndërqeveritare nuk mund të merr pjesë në votim nëse ndonjëri nga anëtarët-shtete të saj, është anëtare-shtet e një organizate tjetër ndërqeveritare dhe ajo organizatë ndërqeveritare merr pjesë në atë votim.

(5) *[Shumica]*

(a) Sipas nenit 22 paragrafët (2) dhe (3), vendimet e Kuvendit sillen me shumicë prej dy të tretave të votave.

(b) Gjatë përcaktimit se a është arritur shumica e nevojshme, vetëm votat e dhëna merren parasysh. Të përmbajturit nuk konsiderohen si vota.

(6) *[Seanca]* Kuvendi konvokohet nga drejtori gjeneral dhe, në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme, gjatë të njëjtës periudhë dhe në të njëjtin vend si edhe Asambleja gjenerale e Organizatës.

(7) [Rregullat e procedurës] Kuvendi vendos rregulla të veta të procedurës, përfshirë edhe rregullat për thirrjen e seancave të jashtëzakonshme.

Neni 24

Byroja ndërkombëtare

(1) [Detyra administrative]

(a) Byroja ndërkombëtare i kryen detyrat administrative në lidhje me këtë marrëveshje.

(b) Në veçanti, Byroja ndërkombëtare i përgatit takimet dhe siguron sekretariat të Kuvendit, si edhe komitetet të tilla të ekspertëve dhe grupeve punuese çfarë do të përcaktojë Kuvendi.

(2) [Takime që nuk janë seanca të Kuvendit] Drejtori gjeneral thërret komitetin dhe grupet e punës të formuara nga Kuvendi.

(3) [Roli i Byrosë ndërkombëtare në Kuvend dhe takimet tjera]

(a) Drejtori gjeneral dhe personat e emëruar nga drejtori gjeneral do të marrin pjesë pa të drejtë vote në të gjitha takimet e Kuvendit, komiteteve dhe grupeve punuese të formuara nga Kuvendi.

(b) Drejtori gjeneral apo anëtari i personelit të emëruar nga drejtori gjeneral është për nga detyra zyrtare sekretar i Kuvendit dhe i komiteteve dhe grupeve punuese nga nënparagrafi (a).

(4) [Konferencat]

(a) Byroja ndërkombëtare, në pajtim me udhëzimet e Kuvendit, i përgatit konferencat revizore.

(b) Byroja ndërkombëtare mund të konsultohet në lidhje me përgatitjet e cekura me shtetet-anëtare të Organizatës, organizatat ndërqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare dhe nacionale joqeveritare.

(c) Drejtori gjeneral dhe personat e emëruar nga drejtori gjeneral marrin pjesë pa të drejtë vote në diskutimet e konferencave revizore.

(5) [Detyra të tjera] Byroja ndërkombëtare kryen edhe detyra të tjera që i janë dhënë në lidhje me këtë marrëveshje.

Neni 25

Ndryshime apo plotësime

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet apo plotësohet në konferencë diplomatike. Vendimin për konvokimin (thirrjen) e konferencës diplomatike e sjell Kuvendi.

Neni 26

Të bërit palë nënshkruese e Marrëveshjes

(1) [*Plotësimi i kushteve*] Subjektet në vijim mund të nënshkruajnë dhe në pajtim me paragrafët (2) dhe (3) dhe nenin 28 paragrafët (1) dhe (3) të bëhen palë të kësaj marrëveshje:

(i) Çdo shtet-anëtarë i Organizatës në të cilën mund të regjistrohen marka tregtare në Entin e tij;

(ii) Çdo organizatë ndërqeveritare që ka Ent në të cilin mund të regjistrohen marka tregtare me vlefshmëri në territorin në të cilin zbatohet marrëveshja konstituive e organizatës ndërqeveritare, në të gjitha shtetet e saj anëtare ose në ato shtete-anëtare që janë përcaktuar për këtë qëllim në aplikim përkatës, me kusht të gjithë shtetet-anëtare të organizatës ndërqeveritare të jenë pjesë e Organizatës.

(iii) Çdo shtet-anëtar i Organizatës në të cilin mund të regjistrohen markat tregtare vetëm përmes entit të një shtetit tjetër të përcaktuar që është anëtare e Organizatës;

(iv) Çdo shtet-anëtar i Organizatës në të cilin mund të regjistrohen markat tregtare vetëm përmes entit të cilin e udhëheq organizata ndërqeveritare në të cilën shteti është anëtar;

(v) Çdo shtet-anëtar i Organizatës në të cilin mund të regjistrohen marka tregtare vetëm përmes Entit që është i përbashkët për një grup shtete-anëtare të Organizatës.

(2) [*Ratifikimi ose aderimi*] Çdo subjekt nga paragrafi (1) mund të deponojë

(i) instrument për ratifikim, nëse ka nënshkruar këtë marrëveshje, dhe

(ii) instrument për aderim (anëtarësim), nëse nuk e ka nënshkruar këtë marrëveshje.

(3) [*Data e hyrjes në fuqi e deponimit*] Data e hyrjes në fuqi e deponimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit është:

(i) data në të cilën është deponuar instrumenti i atij shteti, në rast të shtetit nga paragrafi (1)(i)

(ii) data në të cilën është deponuar instrumenti i organizatës ndërqeveritare, në rastin e organizatës ndërqeveritare,

(iii) data në të cilën kushti vijues është plotësuar: instrumenti i atij shteti është deponuar dhe instrumenti i një shteti tjetër të caktuar është deponuar, në rastin e shtetit nga paragrafi (1)(iii),

(iv) data që zbatohet nga pika e lartpërmendur (ii), në rast të shtetit nga paragrafi (1)(iv), dhe

(v) data në të cilën instrumentet e të gjithë shteteve-anëtare të grupit janë deponuar, në rastin e shteteve-anëtare të një grupi shtetesh nga paragrafi (1)(v).

Neni 27

Zbatimi i TLT të vitit 1994 dhe kësaj marrëveshje

(1) *[Marrëdhëniet midis palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje dhe TLT 1994]* Kjo marrëveshje do të zbatohet në raportet e përbashkëta të palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje dhe të TLT 1994.

(2) *[Raportet midis palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje dhe palëve nënshkruese të TLT 1994 që nuk janë palë e kësaj marrëveshje]* Çdo palë nënshkruese e kësaj marrëveshje dhe e TLT 1994 do të vazhdojë të zbatojë TLT 1994 në raportet e tyre me palët nënshkruese të TLT 1994 që nuk janë pjesë e kësaj marrëveshje.

Neni 28

Hyrja në fuqi;

Data e hyrjes në fuqi e ratifikimit dhe anëtarësimit

(1) *[Instrumentet që merren parasysh]* Për qëllimet e këtij neni merren parasysh vetëm instrumentet për ratifikimin apo anëtarësimin që deponohen nga ana e subjekteve nga neni 26 paragrafi (1) dhe që kanë datë të hyrjes në fuqi sipas nenit 26 paragrafi (3).

(2) *[Hyrja në fuqi e Marrëveshjes]* Kjo marrëveshje hyn në fuqi tre muaj pasi dhjetë shtete apo organizata ndërqeveritare nga neni 26 paragrafi (1)(ii) të deponojnë instrumentet e tyre për ratifikim apo anëtarësim.

(3) [*Hyrja në fuqi e ratifikimit apo anëtarësimit pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes*] Çdo subjekt që nuk është i përfshirë me paragrafin (2) obligohet me këtë marrëveshje tre muaj pas datës në të cilën ka deponuar instrumentin e tij të ratifikimit apo anëtarësimit.

Neni 29 Rezervat

(1) [*Lloje të veçanta të markave tregtare*] Çdo shtet apo organizatë ndërqeveritare mund të shpallë përmes rezervave se, përkundër nenit 2(1) dhe (2)(a), secila nga dispozitat e neneve 3(1), 5, 7, 8(5), 11 dhe 13 nuk do të zbatohet në marka të asociuara, marka defanzive apo marka derivateve. Këso rezervash do të specifikohen në ato dispozita paraprakisht të cekura për të cilat bëjnë fjalë rezervat.

(2) [*Regjistrimi në më shumë klasa*] Çdo shtet apo organizatë ndërqeveritare legjislatore i të cilit në datën e miratimit të kësaj marrëveshje parasheh regjistrim në më shumë klasa të produkteve dhe regjistrim në më shumë klasa të shërbimeve, mund, kur hyn në fuqi kjo marrëveshje, të shpall se dispozitat nga neni 6 nuk do të vlejné.

(3) [*Shqyrtim esencial në rast të ripërtëritjes*] Çdo shtet apo organizatë ndërkombëtare mund të shpallë rezerva se përkundër nenit 13(4), Enti mundet, gjatë ripërtëritjes së parë të regjistrimit që mbulon shërbimet, të shqyrtojë esencialisht këtë regjistrim, me kusht shqyrtimi i tillë të jetë i kufizuar në eliminimin e regjistrimeve të shumëfishta në bazë të aplikimeve të dorëzuara gjatë periudhës prej gjashtë muajve pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit të shtetit apo organizatës që e ka miratuar, para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, mundësia për regjistrimin e markave shërbyese tregtare.

(4) [*Të drejta të caktuara të pranuesit të licencës*] Çdo shtet apo organizatë ndërqeveritare mund të shpall rezervë se përkundër nenit 19(2), kërkon regjistrim të licencës si kusht për çdo të drejtë që pranuesi i licencës mund ta ketë sipas ligjit të atij shteti apo organizate ndërqeveritare për futje drejt procedurës për shkeljen e së drejtës së markës tregtare që është lëndë e licencës.

(5) [*Modalitete*] Çdo rezervë nga paragrafët (1), (2), (3) ose (4) dorëzohet me deklaratë të shoqëruar me dokument për ratifikim apo dokument për aderim në këtë marrëveshje të shtetit apo organizatës ndërqeveritare e cila e shpall rezervën.

(6) [*Tërheqja*] Çdo rezervë nga kjo marrëveshje, nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4), mund të tërhiqet në çdo kohë.

(7) [Ndalesë për rezerva të tjera] Nuk lejohet asnjë rezervë tjetër në këtë Marrëveshje, përveç rezervat e lejuara në paragrafët (1), (2), (3) dhe (4).

Neni 30

Anulimi i Marrëveshjes

(1) [Njoftimi] Çdo palë nënshkruese mund të heq dorë (anulojë) nga Marrëveshja me njoftim të drejtuar drejt drejtorit gjeneral.

(2) [Data e hyrjes në fuqi] Anulimi hyn në fuqi një vit nga data në të cilën drejtori gjeneral ka marrë njoftimin. Kjo nuk do të ndikojë në zbatimin e kësaj marrëveshje në cilëndo aplikacion në procesin e përpunimit apo në cilëndo markë tregtare që për palën nënshkruese është regjistruar në kohën e skadimit të periudhës së cekur njëvjeçare, gjatë së cilës pala nënshkruese që bën anulimin, mund, pas skadimit të periudhës së cekur njëvjeçare, të ndërpresë zbatimin e kësaj marrëveshjeje në cilëndo regjistrim nga data në të cilën ai regjistrim duhet të rinovohet (ripërtërihet).

Neni 31

Gjuhët e Marrëveshjes; Nënshkrimi

(1) [Tekstet origjinale; Tekstet zyrtare]

(a) Kjo marrëveshje nënshkruhet në një dokument origjinal në anglisht, arabisht, kinezisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht, ndërkohë që të gjithë tekstet janë njëtrajtësisht autentik.

(b) Tekstin zyrtar në gjuhë që nuk është përfshirë në nënparagrafin (a), ndërsa është gjuhë zyrtare e palës nënshkruese, e përcakton drejtori gjeneral pas konsultimeve me palën e cekur nënshkruese dhe çdo palë tjetër nënshkruese të interesuar.

(2) [Afati i nënshkrimit] Kjo marrëveshje do të mbetet e hapur për t'u nënshkruar në selinë e Organizatës një vit pas miratimit të saj.

Neni 32

Depozitari

Drejtori gjeneral është depozitar i kësaj marrëveshje.

Rregullore sipas Marrëveshjes së Singaporit për të drejtat e markës tregtare

Rregulli 1 Shkurtesa shprehjesh

(1) [*Shkurtesa shprehjesh të definuar në Rregullore*] Për qëllimet e kësaj Rregullore, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe:

(i) „Marrëveshje“ do të thotë Marrëveshja e Singaporit për të drejtat e markave tregtare;

(ii) „Neni“ ka të bëjë me nen të caktuar të Marrëveshjes;

(iii) „Licencë përjashtuese“ do të thotë licencë që i jepet vetëm një pranuesi të licencës dhe që përjashton të drejtën e bartësit ta shfrytëzojë markën tregtare dhe të jap licenca personit tjetër;

(iv) „solo licencë “ do të thotë licenca që i jepet vetëm një pranuesi të licencës dhe që përjashton të drejtën e bartësit të ndajë licenca personit tjetër, por nuk përjashton të drejtën e bartësit (poseduesit) ta shfrytëzojë markën tregtare;

(v) „licencë jopërjashtuese“ do të thotë licenca që nuk përjashton të drejtën e bartësit ta shfrytëzojë markën tregtare ose të ndajë licenca personit tjetër.

(2) [*Shprehje të shkurtuara të definuara me këtë marrëveshje*] Shprehjet e shkurtuara të definuara në nenin 1 për qëllimet e Marrëveshjes kanë të njëjtin kuptim edhe për qëllimet e kësaj Rregullore.

Rregulli 2 Mënyra e listimit të emrave dhe adresave

(1) [*Emrat*]

(a) Kur duhet të potencohet emri i personit, çdo palë nënshkruese mund të kërkojë:

(i) kur pala (personi) është person fizik, emri që kërkohet të jetë mbiemri dhe emri apo emrat e atij personi ose emri që kërkohet, sipas zgjedhjes së personit, të jetë emri ose emrat që zakonisht i shfrytëzon personi në fjalë;

(ii) kur pala (personi) është person juridik, emri që listohet të jetë emërtimi i plotë zyrtar i atij personi juridik.

(b) Kur duhet të listohet emri i përfaqësuesit që është firmë apo korporatë, çdo palë nënshkruese e pranon si të dhënë të emrit, emërtimin e asaj firme apo korporate që më së shpeshti e shfrytëzon.

(2) [Adresa]

(a) Kur duhet të potencohet adresa e personit, çdo palë nënshkruese mund të kërkojë ajo adresë të potencohet në atë mënyrë që do të plotësojë kushtet e zakonshme për dërgesa të shpejta postare në adresën e listuar, në çdo rast, të përmbajë të gjitha njësitë administrative dhe të përfshijë numrin e shtëpisë apo ndërtesës, nëse ka të tillë.

(b) Kur shkresa deri tek Enti i palës nënshkruese është në emër të dy apo më shumë personave me adresa të ndryshme, ajo palë nënshkruese mund të kërkojë që shkresa e tillë të përmbajë vetëm një adresë për korrespondencë.

(c) Listimi i adresës mund të përmbajë numër telefoni, numër të telefaksimit dhe e-mail adresë dhe, për qëllime të korrespondencës, adresë që dallon nga adresa e potencuar sipas nënparagrafit (a).

(d) Nënparagrafët (a) dhe (c) do të aplikohen *mutatis mutandis* në adresën për shërbime.

(3) [Mënyra të tjera të identifikimit] Çdo palë nënshkruese mund të kërkojë që me shkresë, deri tek Enti, të potencohet numri apo mënyrat tjera të identifikimit, nëse ka, me të cilat aplikuesi, bartësi, përfaqësuesi apo personi tjetër i interesuar është i regjistruar në ent. Asnjë nga palët nënshkruese nuk mund të refuzojë komunikim në bazë mosplotësimi të ndonjë kushti të tillë, përveç për aplikacionet e dorëzuara në formë elektronike.

(4) [Shkrimi që përdoret] Çdo palë nënshkruese mund të kërkojë që cilado shkresë nga paragrafët (1) deri (3) të jetë në shkrim që përdor Enti.

Rregulli 3

Detaje në lidhje me aplikacionin

(1) [Shenja standarde] Kur Enti i palës nënshkruese përdorë shenja (shkronja dhe numra) që i konsideron si standarde dhe kur aplikacioni përmban deklaratë për atë se aplikuesi dëshiron ajo markë tregtare të regjistrohet dhe publikohet me shenja standarde që i përdor Enti, Enti do ta regjistrojë dhe publikojë atë markë tregtare me aso shenjash standarde.

(2) [*Marka tregtare me të cilën kërkohet ngjyrë*] Kur aplikacioni përmban deklaratë se aplikuesi dëshiron të kërkojë ngjyrë si karakteristikë dalluese e markës tregtare, Enti mund të kërkojë në aplikacion të potencohet emri apo kodi i asaj ngjyre apo ngjyrave që kërkohen dhe një listim, të pjesëve kryesore të markës tregtare që janë me ngjyrë.

(3) [*Numri i riprodhimeve*]

(a) Kur aplikacioni nuk përmban deklaratë për atë se aplikuesi kërkon ngjyra të jetë karakteristikë dalluese e asaj marke tregtare, pala nënshkruese nuk mund të kërkojë:

(i) më shumë se pesë riprodhime bardh e zi kur aplikacioni nuk mund, sipas ligjit të asaj pale nënshkruese, ose nuk përmban deklaratë për atë se aplikuesi dëshiron marka tregtare të regjistrohet dhe publikohet me shenja standarde që i përdor Enti i palës nënshkruese në fjalë;

(ii) një riprodhim bardh e zi të markës tregtare, kur aplikacioni përmban deklaratë se aplikuesi dëshiron markë tregtare të regjistrohet dhe publikohet me shenja standarde që i përdor Enti i asaj pale nënshkruese.

(b) Kur aplikacioni përmban deklaratë për atë se aplikuesi dëshiron ngjyrë si karakteristikë dalluese të markës tregtare, pala nënshkruese nuk mund të kërkojë më shumë se pesë riprodhime bardh e zi të asaj marke tregtare dhe pesë riprodhime me ngjyrë të markës tregtare.

(4) [*Marka tregtare tredimensionale*]

(a) Kur aplikacioni përmban deklaratë për atë se marka tregtare është markë tregtare tredimensionale, riprodhimi i markës tregtare do të përmbajë riprodhim grafik dydimensional ose fotografik.

(b) Riprodhimi nga nënparagrafi (a) mund, sipas zgjedhjes së aplikuesit, të përbëhet nga një perspektivë e markës tregtare ose disa perspektiva të ndryshme të markës tregtare.

(c) Kur Enti konsideron se riprodhimi i markës tregtare e dorëzuar nga aplikuesi sipas nënparagrafit (a) jo mjaftueshëm i shfaq karakteristikat e markës tregtare tredimensionale, ai mund të ftojë nga aplikuesi të dorëzojë, në afat të arsyeshëm kohor të përcaktuar në ftesë, më së shumti gjashtë perspektiva të markës tregtare dhe/ose përshkrim me fjalë të asaj marke tregtare.

(d) Kur Enti konsideron se perspektivat e ndryshme dhe/ose përshkrimi i markës tregtare nga paragrafi (c) jo mjaftueshëm i tregojnë (shfaqin) karakteristikat e markës tregtare tredimensionale, ai mund të ftojë aplikuesin të dorëzojë, në afat të arsyeshëm kohor në ftesë, mostër të markës tregtare.

(e) Paragrafi (3)(a)(i) dhe (b) aplikohet *mutatis mutandis*.

(5) [*Markë tregtare holograme, markë tregtare lëvizëse, markë tregtare me ngjyra apo markë tregtare pozicione*] Kur aplikacioni përmban deklaratë për atë se marka tregtare është markë tregtare holograme, markë tregtare lëvizëse, markë tregtare me ngjyra apo markë tregtare pozicione, pala nënshkruese mund të kërkojë një ose më shumë riprodhime të markës tregtare, siç është e përshkruar me ligjin e asaj pale nënshkruese.

(6) [*Marka tregtare që përbëhet nga shenja të padukshme*] Kur aplikacioni përmban deklaratë për atë se marka tregtare përbëhet nga shenja të padukshme, pala nënshkruese mund të kërkojë një ose më shumë prezantime të markës tregtare, shënim për llojin e markës tregtare dhe detajet e markës tregtare, siç është e paraparë me ligjin e asaj pale nënshkruese.

(7) [*Transliterimi i markës tregtare*] Për qëllimet e nenit 3 paragrafi (1)(a)(xiii), kur marka tregtare përbëhet nga apo përmban shkronja që nuk janë shkronja që i përdor Enti apo numra që nuk janë numra që i përdor Enti, mund të kërkohej transliterimi i shkronjave dhe numrave që i përdor Enti.

(8) [*Përkthimi i markës tregtare*] Për qëllimet e nenit 4 paragrafi (1)(a)(xiv), kur marka tregtare përbëhet apo përmban një fjalë apo më shumë fjalë në gjuhë që nuk është gjuha apo një nga gjuhët që i pranon Enti, mund të kërkohej përkthimi i asaj fjale në atë ose ato gjuhë.

(9) [*Afatet për dorëzimin e dëshmisë për përdorimin e markës tregtare*] Afati nga neni 3 paragrafi (3) nuk guxon të jetë më i shkurtë se gjashtë muaj, llogaritur nga data kur është lejuar aplikimi nga ana e Entit të palës nënshkruese ku është dorëzuar aplikacioni. Aplikuesi apo bartësi ka të drejtë të vazhdimet të afatit, në pajtueshmëri me kushtet e parapara me ligjin e palës nënshkruese, për periudha prej së paku gjashtë muaj secila, deri dy vite e gjysmë më së shumti.

Rregulli 4

Detaje në lidhje me përfaqësimin apo adresën e shërbimeve

(1) [*Adresa kur është caktuar përfaqësues*] Kur është caktuar (emëruar) përfaqësues, pala nënshkruese e konsideron adresën e atij përfaqësuesi si adresë për shërbime.

(2) [*Adresa kur nuk është caktuar përfaqësues*] Kur nuk është caktuar përfaqësues, ndërsa aplikuesi, bartësi apo person tjetër i interesuar ka dhënë si adresë të tij një adresë në territorin e palës nënshkruese, ajo palë nënshkruese do ta konsiderojë atë adresë si adresë për shërbime.

(3) [*Afati*] Afati nga neni 4 paragrafi 3(d) llogaritet nga data e pranimit të shkresës nga ai nen nga ana e Entit të palës nënshkruese dhe nuk guxon të jetë më i shkurtë se një muaj kur adresa e personit në emër të të cilit shkruhet shkresa është në territorin e palës nënshkruese dhe nuk guxon të jetë më i shkurtë se dy muaj kur adresa e tillë është jashtë territorit të asaj pale nënshkruese.

Rregulli 5

Detaje në lidhje me datën e dorëzimit

(1) [*Procedura në rast të mosplotësimit të kushteve*] Nëse aplikacioni, në kohën e pranimit të tij nga ana e Entit nuk i plotëson kushtet nga neni 5 paragrafi (1) apo paragrafi (2)(a), Enti menjëherë fton aplikuesin të plotësojë ato kushte në afat të potencuar në ftesë, e kjo është më së paku një muaj nga data e ftesës kur adresa e aplikuesit është në territorin e palës nënshkruese dhe është paku dy muaj kur adresa e aplikuesit është jashtë territorit të palës nënshkruese. Procedimi i ftesave mund të jetë subjekt i pagesës së shpenzimeve të veçanta. Edhe sikur Enti të mos dërgojë ftesën e lartpërmendur, kushtet mbeten të pandryshuara.

(2) [*Data e aplikimit në rast ndryshimi*] Nëse në afatin e caktuar në ftesë aplikuesi nuk vepron sipas shkresës nga paragrafi (1) dhe nuk paguan shpenzimin e duhur, data e aplikimit do të jetë data në të cilën të gjitha treguesit dhe elementët e duhur nga neni 5 (1)(a) janë pranuar nga Enti dhe, kur është e mundur, shpenzimet e nevojshme nga neni 5(2)(a) janë paguar pranë Entit. Në të kundërtën, aplikacioni do të konsiderohet sikur nuk është dorëzuar.

Rregulli 6

Detaje lidhur me shkresat (komunikimin)

(1) [*Shënime që shoqërojnë nënshkrimin e shkresës në letër*] Çdo palë nënshkruese mund të kërkojë nënshkrimi i personit fizik që nënshkruan të shoqërohet me:

(i) shënim me shkronja të emrit dhe mbiemrit ose emrave të atij personi, ose sipas zgjedhjes të atij personi, emri apo emrat që ai person më shpesh i shfrytëzon.

(ii) shënim për atë se në cilësinë e kujt nënshkruan, kur cilësia (funksioni) nuk është e qartë në shkresë.

(2) [*Data e nënshkrimit*] Çdo palë nënshkruese mund të kërkojë nënshkrimi të shoqërohet me shënim për datën në të cilën nënshkrimi hyn në fuqi. Kur shënimi kërkohet, por nuk është dorëzuar, data në të cilën nënshkrimi konsiderohet se është kryer do të jetë data në të cilën shkresa me nënshkrim është pranuar nga ana e Entit ose, nëse pala nënshkruese lejon, datën para asaj date të mëvonshme.

(3) [*Nënshkrimi i shkresave në letër*] Kur shkresa deri tek enti i palës nënshkruese është në letër dhe kërkohet nënshkrim, pala nënshkruese:

(i) në pajtim me pikën (iii), pranon nënshkrim me dorë

(ii) nuk mund të lejojë, në vend të nënshkrimit me dorë, të përdoren forma tjera të nënshkrimit, si është nënshkrimi i printuar apo nënshkrim me vulë, apo përdorimin e vulës apo etiketës së bar-koduar.

(iii) kur personi fizik që nënshkruan shkresën është shtetas i palës nënshkruese dhe adresa e atij personi është në territorin e tij ose kur personi juridik në emrin e të cilit është nënshkruar shkresa është organizuar sipas ligjeve të tij dhe ka ose vendqëndrim ose seli faktike industriale apo tregtare në territorin e tij, mund të përdoret vula në vend të nënshkrimit me dorë.

(4) [*Nënshkrimi i shkresave në letër të dorëzuara përmes mjeteve elektronike të transferimit*] Pala nënshkruese që parasheh shkresa në letër të dorëzohet përmes mjeteve elektronike të transferimit, e konsideron çdo shkresë si të nënshkruar nëse riprodhimi grafik i shkresës i pranuar nga ajo palë nënshkruese, sipas paragrafit (3), shfaqet në shkresë si e pranuar.

(5) [*Origjinali i shkresës në letër dorëzuar përmes mjeteve elektronike të transferimit*] Pala nënshkruese që parasheh shkresa në letër të dorëzohet përmes mjeteve elektronike të transferimit, mund të kërkojë të dorëzohet origjinali i kësaj shkrese:

(i) Deri tek Enti bashkë me letër në të cilën do të identifikohet ajo shkresë e mëparshme dhe

(ii) në afat që nuk do të jetë më i shkurtë se një muaj nga data në të cilin ka marrë (pranuar) shkresën përmes mjeteve elektronike të transferit.

(6) [*Vërtetimi i autenticitetit të shkresës në formë elektronike*] Pala nënshkruese që lejon dorëzimin e shkresave në formë elektronike mund të kërkojë që autenticiteti i asaj shkrese të vërtetohet përmes sistemit të vërtetimit elektronik të autenticitetit siç është paraparë nga ajo palë nënshkruese.

(7) [*Data e pranimit*] Çdo palë nënshkruese ka të drejtë të përcaktojë rrethanat në të cilat pranimi i dokumentit apo pagesa e shpenzimeve do të konsiderohet se

përfaqëson pranim nga ana e Entit apo pagesat pranë Entit, në rastet në të cilat dokumenti është pranuar ose është paguar shpenzimi në:

- (i) filial apo njësi e Entit,
- (ii) Ent kombëtar në emër të Entit të palës nënshkruese, kur pala nënshkruese është organizatë ndërqeveritare nga neni 26 paragrafi (1)(ii),
- (iii) postë zyrtare,
- (iv) shërbime dërgesash apo agjenci, e caktuar nga pala nënshkruese dhe
- (v) adresë që nuk është ndër adresat e Entit.

(8) [*Dorëzimi elektronik*] Lëndë e paragrafit (7), kur pala nënshkruese parasheh dorëzimin e shkresave në formë elektronike apo përmes mjeteve elektronike të transferit dhe shkresa është dorëzuar, data në të cilën Enti i asaj pale nënshkruese pranon shkresën në atë formë ose përmes aso mjeteve, është data e pranimin të shkresës.

Rregulli 7

Mënyra identifikimit të aplikacionit pa numër të aplikimit

(1) [*Mënyra e identifikimit*] Kur kërkohet aplikimi të identifikohet sipas numrit të aplikimit, ndërsa numri i tillë ende nuk është lëshuar (ndarë) ose nuk i është njohur aplikuesit apo përfaqësuesit të tij, ai aplikimi do të konsiderohet si i identifikuar nëse dorëzohen si në vijim:

- (i) numri i përkohshëm i aplikimit, nëse ka një të tillë që e jep Enti, ose
- (ii) kopje e aplikimit, ose
- (iii) riprodhimi markës tregtare, bashkë me tregues për datën për të cilën, sipas njohurive të aplikuesit apo përfaqësuesit, aplikimi është pranuar nga ana e Entit dhe numër identifikues i dhënë aplikimit nga ana aplikuesit apo përfaqësuesit.

(2) [*Ndalesë për kushte të tjera*] Asnjë nga palët nënshkruese nuk mund të kërkojë të plotësohen kushte të tjera, përveç atyre nga paragrafi (1), me qëllim të identifikimit të aplikacionit kur numri i tij i aplikimit ende nuk është lëshuar ose nuk iu është njohur aplikuesit apo përfaqësuesit të tij.

Rregulli 8

Detaje në lidhje me vlefshmërinë dhe rinovimin (ripërtëritjen)

Për qëllimet e nenit 13 paragrafi (1)(c), periudha gjatë së cilës mund të dorëzohet kërkesa për rinovim dhe mund të paguhet pagesa për rinovim, fillon më së paku gjashtë muaj para datës kur është parashikuar rinovimi dhe mbaron më së paku gjashtë muaj pas asaj date. Nëse dorëzohet kërkesë për rinovim dhe/ose janë paguar shpenzimet për rinovim pas datës kur është parashikuar rinovimi, çdo palë nënshkruese mund të veprojë, pranimi i kërkesës për rinovim t'i nënshtrohet pagesës shtesë.

Rregulli 9

Masa lehtësuese në rast të mosrespektimit të afateve

(1) *[Kushtet në lidhje me vazhdimin e afateve nga neni 14 paragrafi (2)(i)]* Pala nënshkruese që parasheh vazhdimin e afatit nga neni 14 paragrafi (2)(i), e vazhdon afatin për periudhë të arsyeshme kohore nga data e dorëzimit të kërkesës për vazhdimin dhe mund të kërkojë që kërkesa:

(i) të përmbajë informacione për palën që kërkon, numrin adekuat të aplikimit apo regjistrimit dhe afatin përkatës, dhe

(ii) të dorëzohet në afat që nuk do të jetë më i shkurtë se dy muaj nga data e skadimit të afatit.

(2) *[Kushtet në lidhje me procedimin e vazhdueshëm të procedurës nga neni 14 paragrafi (2)(ii)]* Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa për procedim të vazhdueshëm të procedurës nga neni 14 paragrafi (2)(ii):

(i) të përmbajë identifikim të palës që kërkon, numër përkatës të aplikacionit apo regjistrimit dhe afat përkatës, dhe

(ii) të dorëzohet në afat që nuk do të jetë më i gjatë se dy muaj nga data e skadimit të afatit përkatës. Veprimet e lëna anash kryhen në të njëjtin afat ose, nëse parasheh pala nënshkruese, bashkë me kërkesën.

(3) *[Kushte në lidhje me rivendosjen e të drejtave sipas nenit 14 paragraf (2)(iii)]*

(a) Pala nënshkruese mund t[ë kërkojë që kërkesa për rivendosjen e të drejtave nga neni 14 paragrafi (2)(iii):

(i) të përmbajë identifikim nga pala kërkuese, numrin përkatës të aplikacionit apo regjistrimit dhe afatin përkatës, dhe

(ii) të përcaktojë faktet dhe dëshmitë në mbështetje të arsyeve për lëshimin (mosrespektimin) e afateve.

(b) Kërkesa për rivendosjen e të drejtave dorëzohet deri tek Enti në afat të arsyeshëm, kohëzgjatjen e së cilës e përcakton pala nënshkruese nga data e largimit (eliminimit) të arsyeve për lëshimin e afatit. Veprimi i munguar kryhet në të njëjtin afat ose, nëse parasheh ligji, bashkë me kërkesën.

(c) Pala nënshkruese mund të parashoh afat maksimal kohor për plotësimin e kushteve sipas nënparagrafëve (a) dhe (b), jo më të gjatë se gjashtë muaj nga data e skadimit të afatit.

(4) [Përjashtime nga neni 14 paragrafi (3)] Përjashtimet nga neni 14 paragrafi (3) janë rastet e mosarritjes së afateve kohore:

(i) për të cilat vetëm së është përcaktuar masë lehtësuese sipas nenit 14 paragrafi (2),

(ii) për dorëzimin e kërkesës për masa lehtësuese sipas nenit 14,

(iii) për pagesën e shpenzimeve për rinovim (ripërtëritje),

(iv) për veprime para këshillit të ankesave apo trupi tjetër revizor në kuadër të Entit,

(v) për veprime në procedurat *inter partes*,

(vi) për dorëzimin e deklaratës nga neni 3 paragrafi (1)(a)(vii) apo deklaratës nga neni 3 paragrafi (1)(a)(viii),

(vii) për dorëzimin e deklaratës, me të cilën, sipas ligjit të palës nënshkruese, mund të përcaktohet datë e re për dorëzimin e aplikacionit, dhe

(viii) për ndryshimin apo plotësimin e kërkesës për të drejtën e prioritetit (përparësisë).

Rregulli 10

Kushtet në lidhje me kërkesën për regjistrimin e licencës ose për ndryshimin apo anulimin e regjistrimit të licencës

(1) [*Përmbajtja e kërkesës*]

(a) Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa për regjistrimin (evidentimin) e licencës sipas nenit 17 paragrafi (1) të përmbajë disa nga treguesit apo elementët e mëposhtëm:

(i) emri dhe adresa e bartësit;

(ii) kur bartësi ka përfaqësues, emri dhe adresa e atij përfaqësuesi;

(iii) kur bartësi ka adresë për shërbime, atë adresë;

(iv) emri dhe adresa e pranuesit të licencës;

(v) kur pranuesi i licencës ka përfaqësues, emri dhe adresa e atij përfaqësuesi;

(vi) kur pranuesi i licencës ka adresë për shërbime, atë adresë;

(vii) emri i shtetit shtetas i të cilit është pranuesi i licencës nëse është shtetas i cilitdo shtet, emri i shtetit në të cilin pranuesi i licencës ka vendbanim, nëse ekziston i tillë, dhe emri i shtetit në të cilin pranuesi i licencës ka seli faktike dhe efektive industriale apo tregtare, nëse ka të tillë;

(viii) kur bartësi apo pranuesi i licencës është person juridik, natyra juridike e atij personi juridik dhe shteti dhe, kur është e mundur, njësia territoriale në kuadër të atij shteti, në bazë ligjit sipas të cilit ai person juridik është organizuar;

(ix) numri i regjistrimit të markës tregtare që është lëndë e licencës;

(x) emrat e produkteve dhe/ose shërbimeve për të cilat ndahet licenca, të grupuara sipas klasave të klasifikimit të Nicës, gjatë së cilës para çdo grupi qëndrojnë numri i klasës në atë klasifikim se cilit grup produktesh apo shërbimesh i takon dhe është prezantuar sipas renditjes së klasave në klasifikimin e cekur.

(xi) kur licenca është licencës përjashtuese, licencë përjashtuese apo licencë solo;

(xii) kur është e mundur, licenca të ketë të bëjë vetëm me një pjesë të territorit;

(xiii) kohëzgjatja e licencës.

(b) Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa për ndryshim apo anulim të regjistrimit të licencës sipas nenin 18 paragrafi (1) të përmbajë disa apo të gjithë treguesit apo elementët vijues:

(i) treguesit nga pikat (i) deri (ix) të nënparagrafit (a);

(ii) kur ndryshimi apo anulimi ka të bëjë me cilindo nga treguesit apo elementët nga nënparagrafi (a), natyra dhe spektri i ndryshimit apo anulimit do të regjistrohet (evidentohet).

(2) [*Elementët mbështetës për regjistrimin e licencës*]

(a) Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa për regjistrimin e licencës të shoqërohet, sipas zgjedhjes së palës nënshkruese, me:

(i) ekstrakt nga marrëveshja për licencë ku janë të potencuar palët dhe të drejtat që licencohen, të vërtetuar nga noteri apo trup tjetër përgjegjës se është ekstrakt i vërtetë i marrëveshjes; ose

(ii) deklaratë e pavërtetuar për licencë, përmbajtja e së cilës përgjigjet me deklaratën nga formulari për licencë, siç është paraparë me Rregullore, dhe e nënshkruar nga pronari dhe shfrytëzuesi i licencës.

(b) Çdo palë nënshkruese mund të kërkojë cilido pronar që nuk është pjesë e marrëveshjes për licencë të jap pëlqim të qartë për licencën në dokument të nënshkruar nga ai.

(3) [*Dokumente shoqëruese për ndryshimin e regjistrimit të licencës*]

(a) Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa për ndryshimin e regjistrimit të licencës të shoqërohet, sipas zgjedhjes së palës që kërkon, me:

(i) dokumente që vërtetojnë ndryshimin e nevojshëm të regjistrimit të licencës; ose

(ii) deklaratë të pavërtetuar për ndryshim të licencës, përmbajtja e së cilës përgjigjet me deklaratën për anulim të formularit për licencë, siç është e paraparë me Rregullore, dhe e nënshkruar nga dhënësi i licencës dhe pranuesi i licencës.

(b) Çdo palë nënshkruese mund të kërkojë cilido pronar që është palë e marrëveshjes për licencë të jap pëlqimin e tij të qartë për ndryshimin e licencës në një dokument të nënshkruar nga vetë ai.

(4) [*Elementë shoqërues për anulimin e regjistrimit të licencës*] Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa për anulimin e regjistrimit të licencës të shoqërohet, sipas zgjedhjes së palës që kërkon, me:

(i) dokumente që vërtetojnë anulimin e nevojshëm për regjistrimin e licencës;

(ii) deklaratë të pavërtetuar për anulim të licencës, përmbajtja e së cilës përgjigjet me deklaratën për anulim të formularit për licencës, siç është parashikuar me Rregullore, dhe e nënshkruar nga dhënësi dhe pranuesi i licencës.